

“Pena” - revista e shkrimtarëve shqiptarë të diasporës

Nga Dalip Greca


Sapo ka dalë nga botimi revista më e re e botës shqiptare, “Pena”, organ i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Është një botim luksoz; kopertina me ngjyra, ka më shumë se 100 faqe. Në revistë janë publikuar jo vetëm krijime të anëtarëve të shoqatës, por edhe të autorëve të njohur të botës shqiptare, autorë të njohur botërorë, intervista, shënime për librat etj. Kryeredaktor i revistës është poeti Gjekë Marinaj, themelues i shoqatës, i cili ka përballuar dhe sponsorizimin e numrit të parë të revistës. “Pena” është përgatitur për shtyp dhe është botuar nga Shtëpia Botuese “Marinaj Publishing” në Amerikë.

Po përse u botua “Pena”? Në vend të përgjigjes vjen thënia e John Adams-it, presidenti i dytë amerikan, i cili i pat shkruar dikur të birit, John Quincy: “Me një poet në xhepin tuaj, ju kurrë nuk do të ndjeheni i vetëm. Nuk do të jetoni kurrë një orë të plogët...”.

Plotësimin e mëtejshëm e bën Gjekë Marinaj tek shkruan:

“Me këtë citim në mendje punon redaksia e revistës “Pena”. Le ta luajë kjo revistë rolin e një medikamenti frymëzues, që çdo familje shqiptare të ketë në tavolinën e kafesë diçka të veçantë nga mëdhështia e gjuhës shqipe dhe, veçanërisht, nga mëdhështia e gjuhës së poetëve dhe shkrimtarëve të diasporës.

Revista e re e diasporës kërkon të ecë në shtigjet që çeli në krye të shekullit të 20-të Noli dhe Konica. Madje në krye të tryezës është vënë poeti Anton Çefa, kryeredaktor i gazetës më të vjetër shqiptare “Dielli” që botohet në Amerikë. Në një studim brilant “Vokacioni atdhetar dhe kontradiktat e Nolit”, Çefa përipiqet që ta zbrësë idhullin në tokë. Me peshoren e farmacistit ai përipiqet që të nxjerrë në dukje vlerat dhe kontradiktat e “ikonës së shqiptarizmit”, peshkopit atdhetar. Artikulli studimor i editorit të “Diellit”, eksploron përmes asaj që është shkruar e asaj që pritet të shkruhet. Ai polemizon me vlerësimin komunist rreth kësaj figure,



Portret nga piktori Ylli Haruni

që padyshim është nga ato figura që peshojnë rëndë në trashëgiminë shqiptare. Çefa i shkon deri në fund pandehmës: “Në vorbullën e kontradiktave noline ato më ngacmueset janë dy: a ka qenë peshkopi ynë i shquar besimtar apo jo besimtar; për të mos thënë kundërshtar i besimit dhe; në zgjidhjen e problemeve të mëdha shoqërore e politike, a ka qenë për përdorimin e dhunës a kundra saj, a ka qenë revolucionar a kundra revolucionar...”

Në numrin e parë të “Penës” i është dhënë një kënd i konsiderueshëm poetit Dritëro Agolli, i cili tregon sekretet se çfarë zien në shpirtin e tij poetik gjatë momenteve magjike të krijimit të poezisë. Dritëroi pohon se poezia nuk vjen nga Zoti. Intervista e realizuar nga Gjekë Marinaj zbulon prioritetet e Agollit, shqiptarizmin e tij, këndvështrimin politik dhe oponencën për proceset e zhvillimeve të tejzgjatura tranzitive. Si një tufë erëmirë manushaqesh vjen cikli i poezive të Agron Tufës, Anton Çefës, Bujar Salihut, Luigj Çekajt, Adnan Mehmetit, Albana Melyshi Lifschinit, Gjeto

Turmalajt, Petraq J. Palit, Shefqet Dibranit, Qazim Rrushajt, Ymet Abdullajt, Lekë Gjokajt. Revista ka hapur fletët e saj edhe për krijuesit e rinj si: Elton Prendi, Zina Mroshaj e Pal Qarraj.

Hapësirë të konsiderueshme i është dhënë tek “Pena” edhe prozës. Shumë interesante është novela e shkrimtarit të njohur, kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Diasporës, Naum Prifti, e titulluar “Tabela përballë”. Më pas vjen tregimi i prozatorit me stil të veçantë rrëfimi, Ramiz Gjini, ish gazetar i Rilindjes Demokratike. Tregimi i tij “Gjurmë xhindi mbi dëborë” të befason me mënyrën e rrëfimit dhe lirizmin e hollë që të josh dhe të jep një ndjesi të veçantë poetike.

Proza e Kolec Traboinit “Vjeshta në kopshtin tim” përcjell subjekte interesante dhe situata shpirtërore që të ngarkojnë shpirtërisht. Interesant është këndvështrimi i Albana Melyshit Lifschinit tek tregimi “Zezakja Oma”.

Në rubrikën “Vizione” lexuesi do të gjejë shkrimin e Gjekë Marinajt “Epistemologjia dhe metamorfizimi në ndihmë të një veprë letrare” si dhe shënime për librat: “Periudha e artë e “Vatres” të autorit prof. Beqir Meta, e librit “Heshtja ka tingull guri” e Anton Çefës; “Një vështrim i poezisë së Qazim Rrushajt”, shkruar nga Peter R. Prifti, “Mos vdis dashuri” e Kolec Traboinit etj.

Nuk po e shfletojmë revistën deri në faqen e fundit, 111, me qëllim që kureshtja e lexuesit të mbetet e hapur. Si stola pushimi në një rrugë të gjatë shërbejnë edhe fotografitë dhe pikturat e vendosura në faqet e revistës. Aty do të gjeni portrete këngëtarësh dhe aktoresh të njohura, do te gjeni këndin e piktorit të Ylli Harunit, portretin përkujtimor të Arshi Pipës etj.

Revistën mund ta bëni tuajën vetëm me \$15. Si mund ta gjeni? Adresa e redaksisë është

Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë Numri i parë Pranverë 2003 \$15



PENA

P.O.Box 833213

Richardson, TX 75083

USA

Tel:(972)669-2561

Fax:(972) 669-2561

Në javën e parë të shkurtit shkrimtarët e diasporës do të takohen në New York.

Emri i restorantit: MACELLERIA

Emri i pronarit: Sejdi Bitiqi

Adresa e restorantit:

48 Ganse Voort St.

9th Avenue, New York, NY 10014

Telefoni i Restor.: (212) 741 2555

Stacioni i trenit më i përshtatshëm: 14W Trenat A, C dhe E

Data e Takimit: Te Dielen, me 9 Shkurt 2003 ne oren 12:00 (te dites)

Kërkohet një menaxher

Kërkohet një menaxher për të udhëhequr një restorant familjar në Michigan.

Pagesa e mirë.

Tel. (586) 530 - 4078



Reklamoni
biznesin tuaj
Thirrni në tel.
212.868.2224

RRUGA ME E SIGURTE DHE ME E SHPEJTE PER NE VENDLINDJE



**KOSOVATOURS
INTERNATIONAL**

Fluturime me aviokompanitë më të njohura për

TIRANE • PRISHTINE • SHKUP • PODGORICE

dhe kudo tjetër në Evropë dhe SHBA

• Përkthime

• Notari

• Garancione

Tel 718.231.0600

Fax. 718.231.4052

4367 Webster Avenue

Bronx, NY, 10470

e-mail: agim@kosova.webmail.com